

SI TË USHTROJMË

ANKESË

NDAJ VENDIMEVE TË ADMINISTRATËS
TATIMORE TË KOSOVËS ?



Faza e hapjes së kontrollit nga ATK

Inspektorët tatimor kanë të drejtë që të kenë qasje në të gjithë dokumentacionin e kompanisë me rastin e hapjes së kontrollit tatimor.

Përveç dokumenteve, inspektorët mund të kërkojnë qasje edhe në pajisje elektronike dhe tatimpaguesi obligohet që të jap fjalëkalimin.

Inspektorët tatimor përpilojnë draft raportin e kontrollit të cilin janë të obliguar që të ja përcjellin tatimpaguesit për komente.

Pas kalimit të afatit për komente, përpilohet raporti i kontrollit i cili po ashtu duhet t'i dorëzohet tatimpaguesit.

Paraqitja e provave nga tatimpaguesi

Tatimpaguesi ka të drejtë që të paraqes prova dhe të jap argumentet e veta lidhur me të gjeturat në draft raportin e kontrollit.

Tatimpaguesit duhet të kenë rol aktiv me rastin e kontrollit. Fillimisht, ATK i jep afat 7 ditor tatimpaguesit që të dorëzon provat.

Afati i fundit për dorëzim të provave është dorëzimi i raportit të kontrollit.

KUJDES: asnjë provë e cila nuk është paraqitur nga tatimpaguesi para raportit të kontrollit **NUK MERRET PARASYSH** nga Komisioni i Ankesave e as nga Gjykata.

Afati për dorëzimin e provave

Neni 14, paragrafi 7 i Ligjit nr.03/L-222 parasheh:

“Nëse një tatimpagues nuk dorëzon informatat e kërkuara brenda afatit kohor të vendosur sipas paragrafit 1. të nenit 15 të këtij ligji (7 ditësh), ai/ajo mund ta bëjë atë deri në datën në të cilën është dorëzuar raporti përfundimtar i vlerësimit nëse ai/ajo është në gjendje të demonstrojë se dokumentet e kërkuara nuk kanë mundur të dorëzohen me kohë për shkak arsyeve të cilat janë përtej kontrollit të tij/saj”.

Kundërshtimi i raportit të kontrollit

Në rast se tatimpaguesi është i pakënaqur me raportin kontrollit, ka të drejtë që të ushtron ankesë e cila shqyrtohet nga Departamenti i Ankesave në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës.

Ankesa duhet të përmban të dhënat e tatimpaguesit, referencën e raportit të kontrollit i cili atakohet, një përmbledhje të fakteve që janë në favor të tatimpaguesit, një sqarim të provave si dhe të bazës ligjore. Po ashtu, ankesa duhet të ketë edhe propozimin se çka kërkohet të vendoset nga Departamenti i Ankesave.

Inicimi i procedurës gjyqësore

Tatimpaguesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit të Ankesave ka të drejtë që në afat prej 30 ditësh të ushtron PADI. **Padia e ushtruar pas këtij afati hedhet si e pas afatshme.**

Për shqyrtimin e padive nga ATK, për personat fizik kompetencë ekskluzive ka Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, divizioni fiskal ndërsa

Kur tatimpaguesi është biznes, kompetente është Gjykata Komerçiale, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Fiskal.

Padia mund të dorëzohet fizikisht në objektin e Gjykatës apo përmes postës, ku data e dorëzimit të padisë në postë konsiderohet datë e dorëzimit në Gjykatë.

Përmbajtja e padisë

Padia duhet të përmban:

Emrin dhe adresën e palës paditëse dhe detaje tjera që mundësojnë identifikimin e paditësit,

Specifikimin se Administrata Tatimore e Kosovës është pala e paditur.

Identifikimin e plotë të vendimit të Komisionit të Ankesave që atakohet në Gjykatë (numrin e referencës dhe datën e vendimit)

Arsyetimin ligjor dhe faktik si dhe faktet mbështetëse

Kërkesëpadinë ku specifikohet se çka kërkohet nga Gjykata.

Nënshkrimin e palës dhe vulën nëse posedon.

Kërkesëpatria

Sipas nenit 81E i ligjit Nr. 04/L-102 Një padi e adresuar tek Gjykata Themelore duhet të përmbajë njërën nga kërkesat në vijim:

Anulimin, e plotë ose të pjesshëm, të vendimit të kundërshtuar;

Kthimin e tatimit të paguar padrejtësisht, i cili nuk është nxjerrë sipas kushteve të parapara;

Që Gjykata të merr vendim i cili nuk është sjellë nga administrata tatimore;

Që gjykata të merr vendim për të zvogëluar borxhin , i cili nuk është marrë sipas kushteve të parapara;

Kthimin e gjërave të konfiskuara dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar për shkak të ekzekutimit të vendimit kontestues.

Shqyrtimi gjyqësor

Gjykata fillimisht vlerëson nëse padia është e rregullt, është dorëzuar në afatin ligjor si dhe nëse janë bashkëngjitur vendimet kontestuese dhe provat tjera.

Një kopje të padisë gjykata ja dërgon Administratës Tatimore të Kosovës për të dhënë përgjigje.

Pas pranimit të përgjigjes nga ATK, Gjykata cakton seancën gjyqësore ku ftohet paditësi (tatimpaguesi) dhe përfaqësuesi i ATK.

Secila palë ka të drejtë që të paraqes argumentet e veta dhe të jap sqarimet që i konsideron të rëndësishme. Pala paditëse mund të propozon nxjerrjen e provës me ekspertizë ku gjykata e cakton një ekspert nga lista e eksperteve të gjykatës. Propozuesi i ekspertizës duhet të specifikon detyrat e ekspertit në mënyrë të qartë.

Pas dëgjimit të palëve dhe administrimit të provave, Gjykata nxjerr AKTGJYKIM me të cilin e aprovon apo e refuzon kërkesëpadinë e paditësi.

Nëse Gjykata e aprovon padinë, mundet që lëndën ta kthen tek ATK për rivendosje apo të vendos meritorisht për rastin.

Procedura e ankimit të vendimit gjyqësor

Palët e pakënaqura me vendimin e Gjykatës së shkallës së parë, kanë të drejtë që në afatin ligjor prej 60 ditësh të ushtrojnë ankesë.

Ankesa i drejtohet Gjykatës së shkallës së dytë përmes Gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë e shqyrton ankesën dhe vendos nëse ankesa është e bazuar ose jo. Gjykata e shkallës së dytë mundet që rastin t'ia kthen në rivendosje Gjykatës së shkallës së parë, ta vendos vet rastin apo ta refuzon ankesën dhe të lë në fuqi vendimin e shkallës së parë.

Vendimet e Gjykatës së shkallës së dytë janë të ekzekutueshme dhe konsiderohen përfundimtare.

Ndaj vendimit të Gjykatës së shkallës së dytë lejohet mjeti i jashtëzakonshëm që njihet si Kërkesë për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm e që i drejtohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Vendimet e gjykatave e obligojnë ATK kur janë të plotfuqishme dhe përfundimtare.